REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 09/17
Datë/Datum. 30.01.2017
PRISHTINË · PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova –Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

AKT PËRCJELLËS

REFERENCË:	09/2017
PËR:	- Zyrtarit e prokurimit të AK-së- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Parashtruesit të ankesës **"STUDIO HAPSIRA" sh.p.k.** me seli në Prishtinë
CC:	- Panelit Shqyrtues në OSHP, - Arkivës në OSHP
NGA:	Sabrije Bullatovci, Ekspert shqyrtues i prokurimit Bullatovci
TEMA:	Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar **"STUDIO HAPSIRA" sh.p.k.** me seli në Prishtinë, me numër protokollit 09/2017, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Hartimi i detyrës projektuese për teatrin e operës dhe baletit "Dr. Ibrahim Rugova" në Prishtinë",** me nr. të Prokurimit: 207/16/107/236, kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues (AK) Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Lokacioni:	Prishtinë	Data:	30.01.2017
PËR AKTIVITET			X
SIÇ ËSHTË KËRKUAR			X
PËR KOMENTE			X
PËR INFORMIMIN TUAJ			X

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Hartimi i detyrës projektuese për teatrin e operës dhe baletit "Dr. Ibrahim Rugova" në Prishtinë",** me nr. të Prokurimit: 207/16/107/236, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues **"STUDIO HAPSIRA" sh.p.k.** me seli në Prishtinë, me numër protokollit 09/17.

Konform nenit *113 dhe 114*, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues i pavarur , ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë,të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

BuMaBai		18.01.2017		19.01.2017		30.01.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të eksp.*		*data e fillimit të ekspertizës*		*data e dorëzimit të raportit*

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit-

Me datën: 10 janar 2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën Nr. 09/2017 e parashtruar nga OE **"STUDIO HAPSIRA" sh.p.k.** me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Hartimi i detyrës projektuese për teatrin e operës dhe baletit "Dr. Ibrahim Rugova" në Prishtinë"**, me nr. të Prokurimit: 207/16/107/236, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues i kanë shqyrtuar dhe analizuar pretendimet ankimore të OE ankues.

N. 109, LPP-Operatori Ekonomik Ankues "STUDIO HAPSIRA" sh.p.k. me seli në Prishtinë

Pikat e Ankesës:

- Shkelje e nenit 7 të LPP-së, Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;
- Shkelje e nenit 10 të LPP-së, Mjetet për promovimin e Transparencës;
- Shkelje e nenit 24 të LPP-së, Zyrtarët e Prokurimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit;
- Shkelje e nenit 27 të LPP-së, Dosja e tenderit;
- Shkelje e nenit 28 të LPP-së, Specifikimi teknik;
- Shkelje e nenit 40 të LPP-së, Njoftimi për kontratë;
- Shkelje e nenit 51 të LPP-së, Njoftimi i kritereve të përzgjedhjes;
- Shkelje e nenit 56 të LPP-së, dispozitat e Përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratës;
- Shkelje e nenit 59 të LPP-së, Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
- Shkelje e nenit 60 të LPP-së, Kriteret për dhënie të kontratës;
- Shkelje e nenit 64 të LPP-së, Dëshmitë e kërkesave;
- Shkelje e nenit 67 të LPP-së, Provat shkresore;
- Shkelje e nenit 69 të LPP-së, Aftësitë teknike dhe/ose profesionale;
- Shkelje e nenit 108/A të LPP-së, Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

- Pas marrjes së dosjes tenderit, me datën 09.11.2016 në ora 1:10 PM sipas versionit të kohës në gmail zyrtarë, kemi bërë kërkesë për sqarim të dosjes tenderit në adresën zyrtare :prokuriminkrs@gmail.com duke kërkuar sqarime në pyetjet në vijim :
- **Operatorët Ekonomik duhet të kenë qarkullim financiar së bashku për tri vitet e fundit (2013.2014.2015) së paku 18,000.00€. 2. Lista e projekteve të përfunduara me sukses 2013-2015 ?**

- KOMENT : Autoriteti kontraktues na ka injoruar duke mos kthyer përgjigje lidhur me kërkesat për sqarim të parashtruar nga ana jonë duke na trajtuar në mënyrë jo-barabartë dhe diskriminues në raport me operatorët tjerë konkurrentë. Kjo ka ndikuar që të eliminohemi padrejtësisht pikërisht në pyetjen të cilin ja kemi parashtruar e cila për ne ka qenë e paqartë, po ti kishim informatat, sqarimet ne nuk do të kishim konkurruar në këtë tender, apo do të hynim në konzorcium me një kompani e -cila i plotëson kriteret e pretenduara.
- Autoriteti Kontraktues tek kriteret e përzgjedhjes ka bërë një devijim nga kërkesat e parashtruara nga njësia e kërkesës duke ju referuar dosjes tenderit dhe njoftimi për kontratë tek NENI III. 4 KËRKESAT MBI MUNDËSIT TEKNIKE DHE/OSE PROFESIONALE :
- Kërkesa 3 - Minimumi Tri Referenca të hartimit te projekteve projektuese për periudhën 2013-2015.
- Evidenca 3 - Të dorëzoj listën e projekteve te përfunduara në periudhën e viteve: 20132015, me dëshmitë e përfundimit, reference apo raport te pranimit të shërbimeve (te përfunduara me sukses).
- ***KOMENT : Autoriteti Kontraktues përmes Letrës Standarde për tenderuesin e eliminuar na ka eliminuar nga ky aktivitet e prokurimit me arsyetim :***

  ARSYETIM
- *Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :*
- */Deklaroni arsyet e hollësishme mbi refuzimin në përputhje me rrethanat)*
- ***Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, sepse nuk keni prezantuar kontrata dhe referenca për objekte shoqërore.***
- Me këtë rast Autoriteti Kontraktues ka bërë një shkelje të rëndë të LPP, Ligjit NR. 04/L- 042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës , i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin NR.04/L-237 , ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin NR. 05/L-092 , gjegjësisht në NENËT 7 , 10, 24,27, 28, 40, 51, 56, 59, 60, 64 dhe 108A etj.
- Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderit qëllimisht ka devijuar kërkesat e përshtatshmërisë profesionale neni III. 4 të dosjes tenderit duke na eliminuar qëllimisht dhe favorizuar O.E GM ARCHITECTURE.
- ***Pretendimet e AK. janë të pa baza dhe të ndikuara qëllimisht, pasi REFRENCA TË OBJEKTEVE SHOQËRORE, nuk specifikohet as në njoftimin për kontratë as në dosjen e tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk e ka specifikuar/precizuar kontratë të natyrës së ngjashme.***
- ***P.S (Po të ishte ne do të marrim si të bazuar arsyetimin mbi eliminimin tonë)***
- ***Qasja e Autoriteti Kontraktues ka qenë jo transparentë dhe diskriminues pasi e njëjta nuk është përgjigjur kërkesës për sqarim të parashtruar nga kompania jonë, e njëjta e ka pezulluar aktivitetin prokurimit pas kërkesë për rishqyrtim dhe nuk e ka rishqyrtuar duke shkelur LPP dhe NENET e specifikuara më lartë.***
- Ne STUDIO HAPSIRA SHPK - Deklarojmë se kemi plotësuar, dërguar dhe dorëzuar të gjithat kërkesat dhe dëshmitë e dokumentuara të parashtruara nga ana e AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit në harmoni me LPP, dhe se të gjitha zarfet si origjinali dhe kopjet kanë qenë të mbyllura.

- Ne STUDIO HAPSIRA SHPK - Kemi Ofertuar me çmimin konkurrues dhe kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi me çmimin me të ultë. Të gjitha AK, janë obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë lëndë dhe qëllimin e prokurimit. Autoriteti Kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të janë në përputhje me qellim e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti Kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojmë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik. KU ME KËTË RAST AK NUK JU KA PËRMBAJTË NJË VEPRIMI TË TILL
- Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë NEN , duhet të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse. AUTORITETI KONTRAKTUES I KA I KUR NJË KRITERI TË TILLË.
- Autoriteti Kontraktues do të përpiloj një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur në kontratën në fjalë, duke përfshirë gjitha tërmet dhe kushtet materiale të saj, procedurat zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkese të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter tjetër të përzgjedhjes ,siç kërkohen nga ky ligj ose siç e sheh të domosdoshëm Autoriteti Kontraktues. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës,dosja e tenderit duhet të përmbajë një kopje të njoftimit të tillë. Autoriteti Kontraktues duhet të përcaktoj dosjen e tenderit , specifikimet teknike të zbatueshme dhe aty ku është e përshtatshme, dhe kërkesat ekzekutuese teknike dhe profesionale konform natyrës që prokurohet.
- Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga operatoret ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe të njoftimit të kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkese, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në kriteret teknike dhe procedurave që shpien drejtë dhënies së kontratës publike në të cilën përfshihet leferimi produkteve/shërbimeve, nga operatorët ekonomik mund të kërkohet që të dëshmojnë aftësinë e tyre teknike përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të produktit/shërbimeve që duhet furnizohen.
- *AUTORITETI KONTRAKTUES NË KËTË RAST NUK KA KËRKUAR SQARIME TË NEVOJSHME LIDHUR ME AFTËSIN PROFESIONALE DHE TEKNIKE*
- *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit , të gjitha autoritete kontraktuese do të sigurojnë (i) pjesëmarrjen me të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit, (ii) publikimi i rregullt, dërgimi dhe /ose disponueshmërinë e gjitha njoftimeve, ftesave , informacioneve dhe dokuementeve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj : (iii) eliminimin e praktikave, kritereve , kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik , (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësin relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë ; (v) që asnjë kërkesë, kriter , specifikim që nuk është saktësuar kështu të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënie ; dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesorë të kushteve, kritereve dhe specifikimeve teknike.*
- **NË KËTË NEN AUTORITETI KONTRAKTUES KA BËRË SHKELJE SERIOZE TË LPP ,GJATË PROCESIT TË PËRZGJEDHJES APO DHËNIES KONTRATËS**

DUKE PËRDORUR KRITERE NË SPECIFIKIMIN TEKNIK I CILI NUK ËSHTË SAKTËSUAR PRECIZUAR NË NJOFTIM PËR KONTRATË/DOSJE TË TENDERIT, DHE ËSHTË PËRDORË GJATË PROCESIT TË DHËNIES KONTRATËS.

- ***PS- Kontrata për objekte shoqërore nuk është saktësuar/precizuar në njoftimin për kontratë as në dosjen e tenderit, ne kemi dorëzuar tri projektet të mbështetura me referenca ashtu siç është kërkuar në njoftimin për kontratë /dosje tenderit.***
- **NUK KA ELEMINUAR PRAKTIKAT E DISKRIMINIMIT PASI, NË KËTË RAST AUTORITETI KONTRAKTUES QELLIMISHT I KA ELEMINUAR NGA GARA OPERATORËT TË CILËT KANË QENË ME ÇMIMIN ME TË LIRË SE OPERATORI TË CILIN E KANË SHPËRMBLYER ME KONTRATË.**
- **ËSHTË FAVORIZUAR OPERATORI EKONOMIK I SHPËRBLYER ME KONTRATË "GM-ARCHITECTURE", PASI NËSE HYMË NË ARKIVEN E NJOFTIMEVE NË KRPP, KOMPANIA ME FJALË ËSHTË SHPËRBLYER VAZHDIMISHT ME TENDER NGA KY AUTORITET KONTRAKTUES.**
- Pas marrjes së kërkesë për rishqyrtim AK, ka vepruar në kundërshtim me NENIN 108 A, pakti nënligjor 6.
- Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.
- *AK NUK E SHQYRTUAR FARE KËRKESËN TONË PËR RISHQYRTIM, E NJETA KA INJORUAR KËRKESËN PËR INFORMATË LIDHUR ME ECURIN E KËSAJ PROCEDURE TË DATËS 05.01.2017.*
- Duke u bazuar në argumentet e specifikuar më lartë kërkojmë nga OSHP të bëjë anulimin për dhënie të kontratës , e njëjta ta kthejë lëndën në rivlerësim dhe të marrë si të bazur kërkesë tonë për ri-shqyrtim të lëndës , pas konsiderojmë që AK gjatë këtij aktiviteti prokurimit ka bërë shkelje serioze të LPP.

Procesi i prokurimit:

Data e autorizimit të prokurimit nga zyrtari autorizues (N. 22.1).....07.11.2016

Data e njoftimit për kontratë (N. 40): 07.11.2016

Lloji i procedurës së aplikuar (N.33-38): ..... Koutim i çmimeve

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: ..... Shërbime/vlerë e vogël

Vlera e parashikuar e kontratës (N.15-19): ..... 9,000,00 €

Data dhe vlera e akordimit të mjeteve financiare nga AK (N.9).....

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 15.11.2016

Data e hapjes së ofertave (N. 58) 15.11.2016

Kriteret për vlerësim

Kriteri për dhënien e kontratës (N. 60): .....Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Kërkesat (administrative) për përshtatshmëri (N.65-69):

- Deklaratë nën betim - Operatori ekonomik duhet t'i përmbushë kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042, Neni 65.
- Vërtetimi nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit
- Vërtetimin nga Gjykata - Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë"- të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Deklaratë nën betim (origjinali).
- Vërtetimi nga Administrata Tatimore (kopje).
- Vërtetimi nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar/noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit).

Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar në vendin e dytë.

Kërkesat përshtatshmërisë profesional (N.66):

- Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit.
- Certifikatë e TVSH-së.
- Certifikatë me numër fiskal e lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Certifikatë e regjistrimit të biznesit (kopje).
- Certifikatë e TVSH-së (kopje).
- Certifikatë me numër fiskal (kopje).
- Certifikatën e Standardeve ISO 9001:2008, për ofrimin e shërbimeve te planifikimit, dizajnit dhe konsultimit ne fushën e inxhinierisë (kopje).

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare (neni 68 të LPP-së)

- Operatoret Ekonomik duhet te kenë qarkullim financiar se bashku për tri vitet e fundit (2013,2014,2015) se paku 18,000.00€.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Raportin ose raportet përkatëse nga një ose me shumë banka mbi kapacitetin ekonomik dhe financiar nga ndonjë banke e licencuar (origjinal).

- Pasqyrat Financiare te Audituara nga Auditori i Licencuar, ose dëshmi nga banka për qarkullimin financiar për tri vitet e fundit (2013,2014,2015) se paku 18,000.00€ (kopje).

Kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale (neni 69 të LPP-së)

- Specifikimi i kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës dhe në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejtë është ose janë përgjegjës për kontratën në fjalë duke i prezantuar:

Minimumi i Kërkesave:

Kërkesa 1

- Tre Inxhinier të Arkitekturës;
- Një Inxhinier të Ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktiv;
- Një Inxhinier të Ndërtimtarisë – Drejtimi Hidroteknik;
- Një Inxhinier të Elektroteknikes;
- Një Inxhinier të Makinerisë.

OE duhet te caktoj një menaxher të projektit i cili duhet të jetë Inxhinier i diplomuar i Arkitekturës, me përvojë pune minimum 10 vjeçare (duhet te jetë njëri nga stafi i prezantuar).

Stafi profesional i prezantuar me bachelor nuk do të numërohen inxhinierë.

- Minimumi Tri Referenca të hartimit te projekteve projektuese për periudhën 2013-2015.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Stafi profesional duhet te dëshmohet me diploma dhe përvojën e punës me reference ne projektim për minimumi 5 vite (ndërsa menaxher i projektit minimumi 10 vite), gjithashtu të dëshmohet me kontratë me byronë projektuese dhe CV-në.

- Stafi profesional i angazhuar të dokumentohen me diploma apo certifikata, kontrate pune me byronë projektuese, referencën për projektime dhe CV-në.

- OE duhet te caktoj një menaxher të projektit i cili duhet të jetë Inxhinier i diplomuar i Arkitekturës, me përvojë 10 vjeçare. Menaxheri i projektit duhet te dëshmohet me diplome dhe përvojën e punës me reference ne projektim për min 10 vite përvoje pune ne byronë projektuese, gjithashtu te dëshmohet me kontrate te rregullt dhe CV-në.

- Të dorëzoj listën e projekteve te përfunduara në periudhën e viteve: 2013- 2015, me dëshmitë e përfundimit, reference apo raport te pranimit të shërbimeve (te përfunduara me sukses).

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N. 58):

Nr.	Emri i OE	Vendi	Çmimi Lot 1
1.	"INTECH"	Prishtinë	8,500.00€
2.	"GM ARCHITECTURE"	Prishtinë	6,962.00€
3.	"STUDIO HAPËSIRA"	Prishtinë	3,398.40€
4.	"NORTH"	Pejë	5,428.00€

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve konstatohet se ne hapjen e ofertave kanë marrë pjesë përfaqësuesit e 3 (tre) OE, ku është lexuar shifra e operatorit ekonomik.

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.59).

Autoriteti kontraktues me dt. 24 nëntor 2016, ka caktuar komisionin për vlerësimin e tenderëve në përbërje 3 (tre) anëtarëve, si në vijim:

- Drenushe Behluli Mehmeti, Arkitekte
- Valon Ibraj, Zyrtar i Lartë për Diplomaci Kulturore
- Fellanza Zhuri-Daladaku, Zyrtar Ligjor në DL
- Nushe Mekuli, Monitoruese nga Divizioni i Prokurimit në MKRS

Data e fillimit dhe mbarimit të vlerësimi:.....16.12.2016

Data e njoftimit për dhënie të kontratës (N.41):.....19.12.2016

Data e vendimit të AK-së mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE (N. 108/A):.....16.01.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

Bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve, komisioni për vlerësimin e ofertave i emëruara me vendimin me nr. 234/2016, i dt. 24.11.2016, punën filloi me dt. 06.12.2016, për vlerësimin e tenderit **"Hartimi i detyrës projektuese për teatrin e operës dhe baletit "Dr. Ibrahim Rugova" në Prishtinë".** Pas procesit të vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve konstaton:

- OE "INTECH" Prishtinë-8,500.00€, operator i papërgjegjshëm ka vërejtje tek dëshmitë e kërkuara ku në formularin e tenderit nuk e ka shënuar vlefshmërinë e tenderit dhe nuk ka prezantuar referenca për stafin përveç për inxhinierin e arkitekturës z. Odhise Zoto.

- OE " GM-ARCHITECTURE" Prishtinë- 6,962.00€, operator ekonomik i përgjegjshëm si nga ana administrative ashtu edhe nga ana tekniko-profesionale.

- OE "STUDIO HAPSIRA" Prishtinë, 3,398.40€, operatori i papërgjegjshëm nuk ka kontrata dhe referenca për objekte shoqërore.

- OE "NORTH" Pejë- 5,428.00€, operator i papërgjegjshëm ka vërejtje tek stafi, nuk ka prezantuar CV për inxhinierin e hidrës z. Musa Sadiku dhe inxhinierin e makinerisë z. Adem Arifi dhe mungojnë referencat për stafin profesional përjashtuar inxhinierin e arkitekturës z. Muhamed Nekoviq.

Komisioni i autorizuar për vlerësim rekomandon që OE " GM-ARCHITECTURE" nga Prishtina, të shpërblehet me kontratë me çmimin e ofruar 6,962.00€, për realizimin e punëve për **"Hartimi i detyrës projektuese për teatrin e operës dhe baletit "Dr. Ibrahim Rugova" në Prishtinë".**

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (N. 113,114)

Sqarimi: Nr. 1

Ekspertja shqyrtues bazuar ne dokumentacioni që ka në shqyrtim konstaton se autoriteti kontraktues në aktivitet të prokurimit **"Hartimi i detyrës projektuese për teatrin e operës dhe baletit "Dr. Ibrahim Rugova" në Prishtinë",** me nr. të Prokurimit: 207/16/107/236, ka aplikuar procedurën koutim i çmimeve. Lloji i kontratës është kontratë publike, shërbime, vlerë e vogël. Dosja e tenderit përfshinë termet dhe kushtet materiale të saja, procedurën e zbatueshme të prokurimit, kërkesat të aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes.

Sqarimi: Nr. 2

Sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankues ku thuhet: "*Autoriteti kontraktues na ka injoruar duke mos kthyer përgjigje lidhur me kërkesat për sqarim të parashtruar nga ana jonë duke na trajtuar në mënyrë jo-barabartë dhe diskriminues në raport me operatorët tjerë konkurrentë. Kjo ka ndikuar që të eliminohemi padrejtësisht pikërisht në pyetjen të cilin ja kemi parashtruar e cila për ne ka qenë e paqartë, po ti kishim informatat, sqarimet ne nuk do të kishim konkurruar në këtë tender, apo do të hynim në konzorcium me një kompani e -cila i plotëson kriteret e pretenduara*", ekspertja shqyrtues bazuar ne shkresat e lëndës sqaron se operatorit ekonomik ankues përmes shkresës elektronike (e-malit) të dt. 09 nëntor 2016, ka parashtruar kërkesë për sqarim pranë autoritetit kontraktues ku thuhet: gjatë shqyrtimit të dosjes kemi hasur ne paqartësi të cilat janë në vijim:

- Operatoret Ekonomik duhet te kenë qarkullim financiar se bashku për tri vitet e fundit (2013,2014,2015) se paku 18,000.00€.

A duhet patjetër të bashkëngjitet raporti financiar i auditimit 2013-2015 apo ne vend të saj mund të përdoret edhe raporti i gjendjes së bankës së licencuar mbi qarkullimin financiar.

- Lista e projekteve të përfunduara me sukses 2013-2015
- Janë kërkuar hartimi i projekteve minimumi 3 projekte të bashkangjitur me referenca apo procesverbal të pranimit të punëve.

Bëhet fjalë për hartim të projekteve të përgjithshme me dëshmi të përfundimit të suksesshëm apo duhet t'ju referohemi natyrës së kontratës?

Ekspertja shqyrtues bazuar ne shkresat e lëndës sqaron se autoriteti kontraktues pyetjeve të parashtruara nga operatorit ekonomik ankues ne kërkesën për sqarim, nuk i ka shqyrtuar dhe kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankues ashtu siç kërkohet ne nenin 53 paragrafi 4 të LPP-së, ku thuhet: *Autoriteti kontraktues menjëherë do të shqyrtojë çfarëdo kërkese të tillë për të përcaktuar nëse operatorët ekonomik kanë apo nuk kanë nevojë për informatat sqaruese ose plotësues të kërkuar në mënyrë që të përgatisin një tender të përgjegjshëm*

Sqarimi: Nr. 3

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues ku thuhet autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 56 dhe 59 të LPP-së respektivisht ku thuhet: *"Pretendimet e AK. janë të pa baza dhe të ndikuara qëllimisht, pasi REFRENCA TË OBJEKTEVE SHOQËRORE, nuk specifikohet as në njoftimin për kontratë as në dosjen e tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk e ka specifikuar/precizuar kontratë të natyrës së ngjashme*", bazuar ne letrën standarde mbi tenderuesin e eliminuar, të dt. 16.12.2016, ekspertja shqyrtues sqaron se komisioni i vlerësimit operatorin e ekonomik ankues e ka eliminuar me arsyetim: *tenderi i juaj është i papërgjegjshëm sepse nuk keni kontrata dhe referenca për objekte shoqërore.*

Ndërsa në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim thuhet: *Arsyeja e eliminimit të operatorit ekonomik ankues nga gara është se referencat e prezantuara janë projekte të hartuara për Kubëzimin e rrugëve dhe kolektorëve për ujëra të zeza dhe një kontratë për një restorant dasmash.*

Bazuar ne atë që u tha më lartë, ekspertja shqyrtues sqaron se është fakt se arsyet e dhëna në letrën standarde mbi tenderuesin e eliminuar nga autoriteti kontraktues për eliminimin e operatorit ekonomik ankues, nuk qëndrojnë për faktin se në dosjen e tenderit te kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale si kriter për kualifikim është kërkuar: *Minimumi Tri Referenca të hartimit te projekteve projektuese për periudhën 2013-2015*, si dëshmi dokumentare: *Të dorëzoj listën e projekteve te përfunduara në periudhën e viteve: 2013- 2015, me dëshmitë e përfundimit, reference apo raport te pranimit të shërbimeve (te përfunduara me sukses)*, që rezulton se nuk janë kërkuar të ofrohen si dëshmi referenca të objekteve shoqërore.

Mirëpo, lidhur me kërkesën e cekur, operatori ekonomik ankues ka ofruar listën e projekteve të realizuara nga "STUDIO HAPSIRA" sh.p.k. gjatë vitit 2013-2016, ku figurojnë dy projekte të realizuar konform kërkesës së AK-së, ku ka të bashkangjitur kontrata dhe referencat, ndërsa ne dosjen e tenderit janë kërkuar *minimumi tri referenca të hartimit te projekteve projektuese për periudhën 2013-2015.*

Sqarimi: Nr. 3

Ekspertja shqyrtues bazuar në dosjen e tenderit respektivisht Pjesa II-Përshkrimi i çmimeve, sqaron se autoriteti kontraktues te përshkrimi ka specifikuar njësia 1, sasia paushall.

Ekspertja shqyrtues bazuar në faktin se kjo kontratë nuk është kontratë kornizë, sqaron se në rastin konkret autoriteti kontraktues me rastin e mos specifikimit të sasisë te përshkrimi i çmimit në dosje të tenderit, nuk ka respektuar nenin 26 paragrafi 1 të Rregullores së Prokurimit Publik, ku thuhet se: *autoriteti kontraktues do të specifikojnë sasitë gjatë përgatitjes së materialeve tenderuese përfshirë publikimet, materialet tenderuese dhe kontratat.*

Sqarimi: Nr. 4

Sa i përket pretendimit të operatorit ekonomin ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 108/A të LPP-së, ekspertja shqyrtues sqaron se operatori ekonomik ankues ka parashtruar pranë autoritetit kontraktues kërkesën për rishqyrtim. Ndërsa, autoritetit kontraktues konform nenit 6 paragrafi 3 të Rregullores për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, me dt. 16 janar 2017, merr vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim duke theksuar vetme arsyet e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues .

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Gjatë analizimit të dosjes së tenderit dhe procedurës së zhvilluar për aktivitetin e prokurimit **"Hartimi i detyrës projektuese për teatrin e operës dhe baletit "Dr. Ibrahim Rugova" në Prishtinë"**, me nr. të Prokurimit: 207/16/107/236, si dhe duke pasur parasysh konstatimin nr. 2 dhe nr. 3, i rekomandon panelit shqyrtues që ankesën e operatorit ekonomik ankues ta aprovoj si të bazuar, ndërsa të anuloj vendimin- njoftimin për dhënie të kontratës të autoritetit kontraktues, të dt. 19 nëntor 2016, dhe lëndën ta kthej në Ri-tenderim.